



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**  
**Sesioni vjeshtor**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 21  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302  
Prishtinë, më 18 nëntor 2015, në orën 11:00

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË**  
**DHE MIRËQENIE SOCIALE**

**Në mbledhje morën pjesë:** Flora Brovina, Fikrim Damka, Fadil Beka, Hatim Baxhaku dhe Adem Hoxha.

**Munguan:** Njomza Emini, Shukrije Bytyçi, Besa Baftiu dhe Time Kadrijaj.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

**Mbledhjen e kryesoi,** Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

**RENDI DITËS:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 28.10.2015;
3. Shqyrtimi i raportit të progresit 2015, pjesa për shëndetësi dhe mirëqenie sociale;
4. Shqyrtimi i projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016:
  - 4.1. Projektbuxhetin për Ministrinë e Shëndetësisë;
  - 4.2. Projektbuxhetin për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
  - 4.3. Projektbuxhetin për Shërbimin Spitalor, Klinik e Universitar të Kosovës.
5. Të ndryshme.

*Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 28.10.2015**

**Kryetarja** konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, më 28.10.2015, pa vërejtje.

## **3. Shqyrtimi i Raportit të progresit 2015, pjesa për shëndetësi dhe mirëqenie sociale**

**Kryetarja** tha se siç jeni në dijen para disa ditësh Bashkimi Evropian ka publikuar Raportin e progresit për Kosovën, për vitin 2015, të cilin besoj se të gjithë ju e keni pranuar dhe atë në versionin anglisht, pasi që ende nuk është përkthyer zyrtarisht në gjuhën shqipe. Para se të hapi debatin për diskutim rreth këtij raporti konstatoj, se konstatimet që kanë dalë në këtë raport janë të ngjashme me ato që ne gjatë këtij viti kemi konstatuar, apo i kemi shqyrtuar dhe diskutuar me të dy ministrat përkatës. Nuk është ndonjë befasi Raporti i progresit për ne, pasi që për çdo vit ka konstatime se ka pak avancim apo lëvizje pozitive në këta dy sektorë, ku në këtë rast reflekton direkt në jetën e qytetarëve. Në këtë rast unë e hapi diskutimin për këtë raport.

**Fikrim Damka** i tha faleminderit kryetare, të nderuar kolegë deputetë. Edhe përkundër se raporti ende nuk është përkthyer, megjithatë unë e kam shqyrtuar, kam vërejtur se disa çështje që janë theksuar në këtë raport, për disa ligje të cilat nuk janë miratuar, ne, si komision, i kemi paraparë në planin e punës për vitin 2015 që t'i shpyrtojmë dhe miratojmë. Në këtë rast Qeveria ndonëse i ka planifikuar në programin legjislativ, ato ende nuk janë proceduar në Kuvend. Në këtë rast ne deri me tani kemi pranuar nga Qeveria, respektivisht nga Ministria e Shëndetësisë vetëm tri projektligje, ku dy prej tyre tashmë jam miratuar. Kurse nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale asnjë projektligj ende nuk e kemi pranuar edhe përkundër se në planin e punës në kemi planifikuar që një numër të projektligjeve t'i shpyrtojmë dhe miratojmë me herët, me qëllim që të përfshihen edhe në Raportin e progresit para publikimit të tij, siç janë Ligji i punës, Ligji për Këshillin Ekonomiko Sociale, e disa ligje të tjera.

Ne, disa herë, kemi diskutuar për Ligjin për Sigurimet Shëndetësore, siç po shihet kësaj radhe nuk është përmendur pasi që tashmë është miratuar. Mirëpo Ligji për Sigurimet Shëndetësore është miratuar, por fatkeqësisht nuk po zbatohet. Siç jeni në dijeni Kuvendi ka miratuar disa marrëveshje ndërkombëtare për financimin e reformave në shëndetësi, sidomos për avancimin apo trajnimin e stafit për themelimin e fondit për sigurimet shëndetësore. Mirëpo ende nuk kemi vërejtur ndonjë lëvizje pozitive në këtë aspekt. Unë mendoj se në javën e ardhshme t'i ftojme të dy ministrat, së pari ministrin e Shëndetësisë, ku do të diskutojmë edhe për Raportin e progresit si dhe për buxhetin në këta sektorë.

**Hatim Baxhaku** tha faleminderit kryetare, të nderuar kolegë. Është e vërtetë se konstatimet të cilat kanë dalë nga Raporti i progresit 2015 janë konstatime që edhe në vetë i kemi trajtuar apo diskutuar shumë herë. Ne mund të konstatojmë se Raporti i progresit është shumë real, mirëpo fatkeqësisht i disfavorshëm sa i përket fushave, si te politikat sociale, shëndetit publik dhe fushën e mirëqenies sociale. Fatkeqësisht edhe pse ne i kemi trajtuar këto çështje disa here si komision, nuk ka ndonjë përparim nga raporti i progresit të vitit të kaluar, me raportin e vitit 2015, dhe kjo na bënë që të angazhohemi shumë më tepër dhe t'i adresojmë këto çështje direkt të ministrat, të kërkojmë nga ta që të ndërmarrin veprime në përmirësimin e situatës në këta dy sektorë. Është e vërtetë se ne e kemi miratuar edhe Ligjin për shëndetësi edhe Ligjin për sigurimet shëndetësore, mirëpo kemi shumë ngecje në zbatimin e tyre. Na mbetet që të jemi më të angazhuar bashkërisht me dy ministrat dhe nëse nuk mundemi që gjatë viti 2016 të kemi buxhet të mjaftueshëm, bile të përgatitemi për vitin 2017 që të kemi një përmirësim të gjendjes në këto dy sektorë.

**Kryetarja** tha të gjithë po pajtohemi që Raporti i progresit është real dhe ai paraqet problemet dhe gjendjen reale të shëndetësisë, si dhe problemet të cilat janë në sektorin e mirëqenies sociale. Për fat të keq shëndetësia në mandatin e kaluar ka qenë një ndër prioritetet e Qeverisë që nuk është tani kjo po shihet edhe në bazë të buxhetit i cili është ndarë. Dhe si përfundim ky buxhet dhe këto planifikime për këtë vit nuk përkojnë me reformat në shëndetësi dhe me kërkesat nga punëtorët shëndetësorë. Gjatë vizitave që patëm në SSHKUK dhe në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, nga afër pamë se në qoftë se nuk mbështetet edhe financiarisht njëri nga prioritetet e Qeverisë, nuk do të këtë sukses funksionalizimi i kardiokirurgjisë, ashtu siç është deklaruar nga Ministria e Shëndetësisë. Një investim shumë i madh në pajisje dhe kushtet e punës, por jo edhe përkrahje të kuadrit profesional, në këtë rast kardiokirurgëve, të cilët janë kthyer në Kosovë me qëllim që ta funksionalizojnë kardiokirurgjinë, në të mirë të qytetareve tanë dhe që t'u ofrojnë shërbime sa më profesionale edhe në kuadër të spitaleve publike, por edhe në këtë rast nuk përkrahën mjaftueshëm financiarisht. Po ashtu gjatë vizitës u njoftuam nga menaxhmenti se kanë nevojë edhe për një numër të kuadrit të mesëm, ku nëpër të gjitha klinikat nevoja është edhe për 150 persona, staf i mesëm. Gjithashtu gjatë vizitës në Klinikën e Pediatriës u njoftuam se pilot-projekti për Sistemin e Informimit Shëndetësor nuk po zhvillohet si duhet dhe ka ngecje në këtë pilot- projekt. Në këtë rast nuk mund të këtë sigurime shëndetësore pa funksionim të Sistemit të Informimit Shëndetësor.

#### **4. Shqyrtimi i projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016**

**Kryetarja** tha se ne kemi pranuar Projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, dhe sigurisht se e kemi analizuar, andaj në bazë të këtij buxheti unë konsideroj se nuk është buxhet i mjaftueshëm për t'i vazhduar reformat në shëndetësi dhe në veçanti për të filluar me aplikimin e sigurimeve shëndetësore. Vizitat që i kemi realizuar si komision në Shqipëri dhe Mal të Zi kemi parë se sa buxhet është i ndarë për shëndetësi. Në Mal të Zi, ku popullsia është shumë më e vogël se te ne, buxheti ishte diku mbi 170 milionë euro. Unë e kam shqyrtuar këtë projektbuxhet dhe të shëndeti primar, në disa komuna, as që është kërkuar buxhet për shëndetësi pra nuk kanë pasur projekte-kërkesa për buxhet për shëndetësi, shumica e komunave kanë pasur kërkesa të vogla për disa renovime dhe pajisje të thjeshta. Me përjashtim Komuna e Prishtinës, ku ka kërkuar buxhet për ndërtimin e dy qendrave të shtëpisë së shëndetit, një në qendër të qytetit dhe tjetrën në lagjen e Veternikut. Ndërsa niveli terciar gjithashtu mbështetet vetëm me pajisje, nuk ka plotësim të nevojave për kuadër shëndetësor, ku gjatë vizitës që kemi realizuar si komision, nga menaxhmenti i SHSKUK-së dhe disa drejtor të klinikave, jemi njoftuar se ka nevojë për kuadër.

Siç e shihni për trajtimin e pacientëve jashtë Kosovës është ndarë një fond diku prej 6 milionë euro, kurse fondi për trajtimin e fëmijëve të prekur nga leukemia i paraparë për këtë vit, ende nuk kemi marrë një raportim apo nuk dimë se ku dhe si janë shpenzuar këto mjete. Gjatë vizitës që realizuam në klinikën e pediatriës, na njoftuan se një numër i fëmijëve që janë të prekur nga kjo sëmundje mund të trajtohen edhe në këtë klinikë, por ju nevojitet një përkrahje më e madhe. Kurse sa i përket projekteve kapitale në shëndetësi, është projekti i ndërtimit të objektit të Qendrës Emergjente, e këtij parashihet të filloj ndërtimi me pare të buxhetit të Kosovës, kurse çdo herë është thënë se do të ndërtohet me donacion.

**Fikrim Damka** i tha faleminderit kryetare, e kam shqyrtuar projekt buxhetin për vitin 2016 dhe nuk kam vërejtur se te Ministria e Shëndetësisë kemi ndonjë rritje të buxhetit për këtë vit, një rritje shumë të vogël e cila nuk korrespondon me atë se Shëndetësia është njëra nga objektivat kryesore të Qeverisë, siç po proklamohet nga ana e saj. Pra, me këtë buxhet unë nuk besoj se

shëndetësia mund të përmirësohet. Ne duhet të diskutojmë me Ministrinë e Shëndetësisë edhe pse është shumë vështirë se do të këtë ndonjë lëvizje apo ndryshim të këtij projektbuxheti. Mirëpo ne duhet t'i bëjmë me dije se ky buxhet është i pa mjaftueshëm për përmirësim të shëndetësisë dhe të kërkojmë që vitet e ardhshme shëndetësia të jetë më të vërtetë prioritet, jo vetëm në dokumente, por edhe me buxhet të mjaftueshëm.

Kurse Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka një rritje të buxhetit për këtë vit. Edhe unë e mbështes idenë që në javën tjetër të ftojme Ministrin e Shëndetësisë dhe të diskutojmë për buxhetin dhe Raportin e progresit, si dhe të shqyrtojmë mundësinë që të paraqesim ndonjë amendament.

**Adem Hoxha** i tha faleminderit kryetare, të nderuar kolegë deputetë. Unë me sa kam parë buxheti për shëndetësi edhe këtë vit nuk është i mjaftueshëm. Unë i përkrahu të gjitha diskutimet e kolegëve sa i përket rritjes se buxhetit për shëndetësi. Fshati nga i cili unë vij, ka 7000 banorë ndërsa në ambulancë nuk ka mjekë që punojnë në ndërrimin e dytë, por për një kontrollim duhet të shkojmë te doktori në Dragash. Ministria e shëndetësisë duhet të këtë me shumë buxhet se sa Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Edhe unë e përkrahu idenë që të ftojme ministrin dhe të diskutojmë rreth buxhetit.

**Fadil Beka** i tha faleminderit kryetare, të nderuar kolegë. Buxheti për sektorin e shëndetësisë është e vërtetë se nuk është i mjaftueshëm, ka nevojë për buxhet më të madh në mënyrë që të kemi edhe shërbime shëndetësore ma të mira. Unë konsideroj se edhe po kemi buxhet pak edhe menaxhimi i tyre nuk po bëhet si duhet dhe për këtë arsye po kemi kritika ndaj sektorit të shëndetësisë. Kurse sa i përket trajtimit të fëmijëve të prekur nga sëmundja e leukemisë, unë me sa kamë informata, këta fëmijë dërgohen për trajtim jashtë edhe përkundër saj trajtimi i kësaj sëmundje ka një kosto shumë të madhe. Po ashtu edhe unë e mbështes idenë që t'i ftojme ministrat dhe të diskutojmë si për Raportin e progresit, ashtu edhe për buxhetin për vitin 2016.

**Hatim Baxhaku** i tha faleminderit kryetare. Ashtu siç u theksua buxheti për vitin 2016 dhe në planifikimet për vitet 2017 dhe 2018, shëndetësia nuk po del prioritet i Qeverisë dhe ky është një lajm i keq. Konsideroj se duhet të ndahet buxhet me i madh për sektorin e shëndetësisë me qëllim të përmirësimit të gjendjes dhe ofrimit të shërbimeve më të mira shëndetësore. Po ashtu ngecjet në funksionalizimin e sistemit të informimit shëndetësor dhe mos fillimi me sigurimet shëndetësore. Për këtë vit kemi diku 6 milionë euro për trajtimin e pacienteve jashtë vendit, konsideroj se këtë shumë të mjeteve duhet rishikuar dhe pse jo një pjesë të kësaj shumë duhet investuar në Kosovë që t'i rrisim kapacitetet tona për ato shërbime që po i dërgojmë pacientet tanë jashtë vendit, dhe t'i fuqizojmë kuadrot tona, si në kardiokirurgji, onkologjinë e fëmijëve etj. Buxheti për barna është shumë i vogël, nuk është gjendja e mirë me furnizimin e barnave nëpër institucionet shëndetësore, diku 6 milionë për furnizim me barna janë ndarë nga Ministria e Shëndetësisë dhe 25 milionë janë ndarë nga SHSKUK-ja, pra kjo shumë nuk i mbulon nevojat për barna. Sistemi i Informimit Shëndetësor është buxhetuar me vetëm 2.755 000 euro një shumë, shumë e vogël duke e ditur rëndësinë e këtij projekti. Po ashtu edhe unë e mbështes idenë që t'i ftojme ministrat dhe të diskutojmë si për Raportin e progresit, ashtu edhe për buxhetin për vitin 2016, pra të shqyrtojmë mundësinë për rritje të buxhetit për sektorin e shëndetësisë, pse jo edhe ndonjë lëvizje brenda vetë buxhetit të shëndetësisë.

**Kryetarja** tha se sa i përket buxhetit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ne kemi vërejtur se është ndarë një buxhet me i madh në krahasim me vitet e kaluara. Këtu kemi rritje pasi që ka filluar edhe implementimi i ligjit për veteranet e UÇK-së, pagesa e pensionit të veteranëve. Ne, gjatë takimit që kemi pasur me ministrin e MPMS-së, z. Abrashin, ja kemi bërë me dije se ka ngecje në mos zbatim të disa ligjeve, apo vonesa të pa arsyeshme si kategorizimi i

pensionistëve dhe pagesa e pensionit kontributdhënës, po ashtu ende nuk ka filluar që të zbatohet ligji për gratë dhe burrat e dhunuar gjatë luftës.

Po ashtu buxheti për Shërbimin Klinik Universitar të Kosovës-SHSKUK- nuk është i mjaftueshëm, duhet t'i bëjmë me dije ministrit se me këtë buxhet nuk mund që t'i mbajë kuadrot profesionale, e sidomos në shërbimin e kardiokirurgjisë, pra me një rrogë 700 deri 800 euro nuk do t'i rrijë asnjë kardiokirurg në kardiokirurgji. Siç u njoftuam nga afër kanë ardhur disa kardiokirurg nga jashtë dhe për këto kuadro duhet të gjendet ndonjë alternativë dhe t'i stimulojë me qëllim që të rrinë dhe të kryejnë shërbime shëndetësore dhe t'i trajnojnë kuadrot e reja.

**Komisioni** pas diskutimit të projektbuxhetit nxori këtë:

### **Përfundim**

- *Të mërkurën, më 25.11.2015, të ftohet ministri i Shëndetësisë, z. Imet Rrahmanin dhe të diskutohet për dy pika, Raportin e Progresit për vitin 2015 për sektorin e shëndetësisë në Kosovë, dhe diskutim rreth projektbuxhetit për vitin 2016, sektorin e shëndetësisë.*

### **5. Të ndryshme.**

**Kryetarja** tha se nëse nuk keni asgjë te kjo pikë, e shpallim të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

### **E përqatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

### **Kryetarja e Komisionit**

---

**Flora BROVINA**